Informacion i Përgjithshëm Periodik Q2-2026

Raiffeisen Bank sh.a, është shoqëri aksionare me seli në "Rruga e Kavajës, Pall 71, Shk.1, Ap.4, Tiranë", e themeluar me datë 10.06.1997 dhe e regjistruar ne regjistrin tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 17426, date 10.07.1997. Numri Unik i Regjistrimit te Subjektit (NUIS) eshte J61911005B.

Kapitali: 14.178.593.030 lekë

Vlera e kapitalit të shlyer: 14.178.593.030 lekë

Numri i aksioneve: 7.000,000

Aksione të zakonshme me vlerë nominale secili: 2.025.513,29 lekë

Aksioner i vetëm: Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Am Stadtpark 9 Wien, Austri, mbajtës i 100% të aksioneve.

Raiffeisen Bank sh.a është pjesë e grupit ndërkombëtar Raiffeisen Bank International AG (RBI), grup i cili është një ndër liderët kryesorë në Austri dhe që është i shtrirë në mesë 15 shtete të Europës Qëndrore dhe Lindore me anë të bankave të rrjetit. Raiffeisen Bank International AG zotërohet nga Raiffeisen Zentralban Osterreich AG (RZB) e cila mban rreth 60.7 përqind të aksioneve ndërsa pjesa tjetër, janë aksione të kuotuara lirisht në bursë dhe zotërohen nga investitorë privatë.

Raiffeisen Bank sh.a zotëron në Republikën e Shqipërisë shoqëritë e më poshtme:

- 100% të aksioneve të *Raiffeisen Invest sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive* me adresë në "Tiranë, Rruga "Tish Daija", Kompleksi Kika 2, Kati 2"
- 100% të aksioneve të *Raiffeisen Leasing Sh.a* me adresë në "Tiranë, , Rruga "Tish Daija", Kompleksi Haxhiu, Godina 1, Kati 7"

Raiffeisen Bank sh.a ushtron aktivitet bankar në Republikën e Shqipërisë bazuar në Licencën nr. 02/1 akorduar nga Banka e Shqipërisë, duke ofruar shërbimet/produktet si vijon:

- ✓ Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore;
- ✓ Qiranë financiare;
- ✓ Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- ✓ Ofrimin e garancive;
- ✓ Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
  - i) Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata të depozitave etj),
  - ii) Këmbim valutor,

Classification: GENERAL

iii) Produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options),

iv) Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen,

v) Letra me vlerë të transferueshme,

vi) Instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare duke përfshirë veprimet me arin,

vii) Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime,

- ✓ Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit ;
- ✓ Ndërmjetësimin për transaksione monetare të më poshtme:
  - i) Administrimin e aktiveve të tilla, si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit,
  - ii) Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letratme vlerë, produktet derivative dhe instrumenta të tjera të negociueshme.
- ✓ Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, ceqet e udhëtarit dhe ceqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) etj, përfshirë emetimin e parasë elektronike.
- ✓ Shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e përfshira në licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.
- ✓ Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare.
- ✓ Ndërmjetësim në sigurime dhe risigurime.
- ✓ Shërbimet e pagesave të listuara nga pika 1 deri në piken 8 të Aneksit 1, të ligjit nr. 55, datë 30.04.2022, "Për Shërbimet e Pagesave", si vijon:
  - Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese,si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese.
  - Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese,si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimine një llogarie pagese.
  - Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
    - ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
    - ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartepagese ose nga një pajisje e ngjashme;
    - ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.
  - Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:

- ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkteqë bëhen vetëm një herë;
- ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një kartë pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
- ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.

o Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave.
o Dërgesat e parave.
o Shërbimi i inicimit të pagesës.
o Shërbimi i informimit të llogarisë.

Struktura dhe pergjegjesite e Organeve Drejtuese

Keshilli Drejtues:

Marie Valerie Brunner - Kryetare
Heinz Wiedner - Zëvendëskryetar
Edzard Janssen - Anëtar
Petro Merkulov - Anëtar
Thomas Matejka - Anëtar

Pergjegjesite:

Këshilli drejtues ka përgjegjësitë kryesore, të cilat përfshijnë, midis të tjerave:

a) miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin rrezikut, buxhetin vjetor;
b) përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;
c) monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;
ç) krijimin e komiteteve, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
d) përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të bankës;
dh) monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
e) marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
ë) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;

f) mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

Komiteti i Kontrollit

Heinz Wiedner - Kryetar
Alda Shehu - Zëvendëskryetare
Thomas Matejka - Anëtar

Komiteti i kontrollit ka këto detyra:

a) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
b) shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
c) propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të bankës;
ç) bën vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
d) kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet kështillin drejtues të bankës;
dh) i jep mendim këshillit drejtues të bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
e) miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga banka, me qëllim publikimin e tyre.

Drejtoria/Bordi i Menaxhimit

Christian Canacaris - Drejtori i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai - Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm
Elona Mullahi (Koci) - Anëtare Bordi për Biznesin e Korporatave
Erion Serti - Anetar Bordi per TI-në dhe Operacionet
Vilma Baçe -Anetare i Bordi per Biznesin Retail

Drejtoria

1. Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës.

2. Drejtoria përcakton dhe mund të delegojë detyrat tek personeli, si dhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësive të deleguara, në përputhje me politikat dhe procedurat e miratuara.

3. Drejtoria ndërmerr masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara.

4. Drejtoria zbaton politikat dhe strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

1. POLITIKA E KONFLIKTIT TE INTERESIT NE NIVEL INSTITUCIONAL

Ne pergjithesi, nje konflikt interesi eshte nje situate kur interesat e nje individi specific (psh nje punonjes ose menaxhues I larte) apo te nje organizate (psh banke ose filialet e saj, divizionet apo departamentet) nuk priten me interesat e RBAL/filialeve te saj dhe/ose te grupit RBI, detyrat ose objektivat (qe mund te perfshije ruajtjen e interesave te nje klienti apo aksioneri) ne nje menyre e cila mund te influencoje nje vendimarrje objective dhe te drejte, performancen e detyrave profesionale ose arritjen e objektivave te RBAL dhe/ose Grupit RBI.

1.1 Koncepte Metodologjike

- Koncepti I konfliktit te interesit "aktual"

Konfliktet e interesit aktuale I referohen sitatave konkrete ne te cilat proceset e vendimarrjes apo te performances se detyrave influencohen nga interesat qe s'jane te RBAL/filialeve te saj dhe/ose te Grupit RBI.

- Koncepti per konfliktet e interesit "arsyeshem te parashikuara potenciale"

Nje influence apo impakt aktual ose efektiv mbi vendimet apo veprimet e RBAL/filialet e saj dhe/ose Grupit RBI nuk nevojitet te kualifikohet per nje situate te caktuar si nje konflikt interesi ne linje me definicionin me lart. Te qenit "arsyeshem I parashikuar potencial" per nje influence apo impakt mbi vendimet apo veprimet eshte i mjaftueshem qe nje sitate te konsiderohet si konflikt interesi.

Nje vleresim per situatat qe mund te kene nje konflikt "arsyeshem te parashikuar potencial" ne influence apo impaktin mbi vendimet dhe veprimet dhe si te tilla kualifikohen si konflikt interesi, mund te behet ne menyre individuale dhe rast pas rasti. Ne pergjithesi nje konflikt "arsyeshem I parashikuar potencial" mund te kete kur punet private, te nje punonjes ose nje anetari I Trupit Menaxhues, takojne pergjegjesite, detyrat, objektivat ose veprimtarite profesionale te zones se tij/saj ne RBAL/filialet e saj dhe/ose Grupin RBI. Eshte pergjegjesia e cdo punonjesi apo anetari te Trupit Menaxhues te identifikoje te tilla situate bazuar ne njohurine e tij/saj me te mire.

Per te qene sa me te thjeshte dhe te lexueshem ky dokument nuk ben dallim midis termit konflikt interesi dhe konflikt potencial interesi. Ku nuk vihet ne dukje ndryshe --- termi "konflikt interesi" mbulon te gjitha aspektet e parimeve te shpjeguara me lart.

- Koncepti I konfliktit te interesit te "perceptuar"

Konflikti I interesit te perceptuar I referohet situatave qe per nje audience te pergjithshme mund te perceptohen apo shfaqen se interesat qe s'jane te RBAL/filialeve te saj dhe/ose Gupit RBI mund te kene nje influence mbi vendimarrjen dhe performancen e detyrave, edhe sikur kjo influence mund te mos jete presente apo e mundur.

Edhe pse ky koncept ne pergjithesi nuk eshte brenda perkufizimeve te konfliktit te interesit te Grupit RBI, sugjerohet te kete nje monitorim te vazhdueshem te konflikteve te interesit te tilla dhe nese nevojitet strategji pro-aktive komunikative per te menaxhuar riskun reputacional.

- Konflikte Interesi qe vazhdojne apo qe ndodhin papritur ne lidhje me nje event te vecante

Konfliktet e Interesit mund te ndahen gjithashtu ne konflikte qe vazhdojne dhe qe duhet te menaxhohen ne menyre permanente dhe konflikte qe ndodhin papritur ne lidhje me nje event te vetem (psh nje transaksion specific, zgjedhja e nje pale sherbimi, etj) dhe qe zakonisht mund te

menaxhohen me nje mase te marre per kete rast. Ky dallim duhet te kihet parasysh gjate procesit te vleresimit dhe mitigimit.

1.2 Tipet dhe Burimet e Konfliktit te Interesit

- Konflikt Interesi Personal

Mund te shfaqet per shkak te lidhjeve te ngushta personale (anetaret e ngushte familjare, lidhjet familjare, lidhje te tjera te ngushta) midis punonjesve/anetareve te Trupit Menaxhues dhe individeve specifike (si psh punonjesve te RBAL/filialeve te saj apo te paleve bashkepunuese te RBAL/filialeve te saj, etj).

- Konflikt Interesi Profesional

Mund te shfaqet kur punonjesit/anetaret e Trupit Menaxhues posedojne funksione qe konfliktuojne me RBA/filialet e saj ose kane funksione apo detyra te tjera (si psh punet dytesore apo mandatet) jashte RBAL/filialeve te saj dhe/ose Grupit RBI.

- Konflikt Interesi Politik

Mund te shfaqet kur punonjesit/anetaret e Trupit Menaxhues mbajne nje pozicion influence te larte politike ose kane lidhje politike (psh lidhje familjare me politikane, etj).

- Konflikt Interesi Ekonomik

Mund te shfaqet kur punonjesit/anetaret e Trupit Menaxhues kane investime/pjesemarrje, detyrime financiare, mbajne marredheniet apo lidhje te tjera biznesi te klienteve me RBAL/filialet e saj (si psh kliente, ofertues, konkurrente, etj).

1.3 Pergjegjesite dhe Detyrat brenda RBAL dhe filialeve te saj

Zbatueshmeria e konceptit te "3 linjave te Mbrojtjes"

Nje menaxhim efektiv I konkfliktit te interesit ne RBAL/filialet e saj dhe/ose ne grupin RBI kerkon perfshirjen e te gjitha linjave te biznesit dhe niveleve te punonjesve/menaxhuesve. Per kete qellim, aplikohet koncepti I "3 linjave te mbrojtjes".

Punonjesit si edhe funksionet menaxhuese konsiderohen funksione te linjes se pare te mbrojtjes (FLoD) dhe marres te riskut per risqet e konfliktit te interesit.

Zyra e Perputhshmerise vepron si nje funksion I linjes se dyte te mbrojtjes (SLoD), duke vleresuar dhe keshilluar rreth risqeve te konfliktit te interesit, si nje pjese e pergjegjesise se pergjithshme te SLoD per luften kunder korrupsionit dhe mitmarries/mitdhenies.

Kontrolli I Brendshem vepron si nje funksion I linjes se trete te mbrojtjes (TLoD), duke survejuar proceset e linjas se pare dhe te dyte.

Punonjesit

Ne pergjithesi, te gjithe punonjesit duhet te permbushin sa vijon:

- Te gjithe punonjesit pritet te identifikojne situatat e konflikteve te interesit, nen rrethana te arsyeshme dhe duhet ti raportojne ato menjehere tek funksioni menaxhues I tyre dhe te Zyra e Perputhshmerise. Ne rast se kini dyshime per situaten, raportimi eshte I detyrueshem.
- Te gjithe punonjesit duhet te ruajne raportimet e konflikteve te tyre te interesit te perditesuara dhe te raportojne ndryshimet perkatese, sic shpjegohet ne seksionet ne vijim.

Kejo mund te perfshije masa sic mund te jene konfirmimet e rregullta (psh 1 here ne vit) tek Zyra e Perputhshmerise rreth mungeses se ndonje situate konflikti ose perputhshmerine me rregullat e kesaj rregulloreje nga ana e punonjesve.

- Per vleresimin individual te konflikteve te interesit, punonjesit respective duhet te bashkepunojne ne menyre aktive ne proces duke siguruar te gjithe informacionin ne njohurine me te mire te tyre, perfshire vendosjen e veprimeve potenciale qe mund te mitigojne konfliktin e interesit.

- Te gjithe punonjesit duhet te rifreskojne kuptueshmerine e tyre dhe njohurite subjektive ne kete ceshtje, ne linje me trajnimet respektive dhe aktivitetet e tjera informuese (qarkoret, etj).

Pamundesia per te qene ne perputhje me sa me lart dhe detyrimet raportuese te specifikuara ne kete politike, konsiderohen shkelje te brendshme (ju lutem referojuni Rregullores se Brendshme te Menaxhimit te Shkeljeve te Brendshme).

Funksionet Menaxhuese

- Funksione ekzekutive te caktuara, si vendimarresit, jane te ekspozuar ne menyre te vecante dhe ata duhet te kene nje nivel njohurie dhe ndjeshmerie te larte ndaj risqeve te konfliktit te interesit, dhe duhet te marrin pjese ne trajnime te zgjeruara.

- Funksionet menaxhuese (sidomos ne nivel Trupi Menaxhues) ne bashkepunim te ngushte te Zyren e Perputhshmerise duhet te kontribojne ne nje nivel te rritur te njohurive lidhur me konfliktet e interesit, duke perkrahur ne menyre te vazhdueshme aktivitetet informuese dhe duke vendosur keshtu theksin nga lart.

- Funksionet menaxhuese jane pergjegjese per identifikimin dhe vleresimin e konflikteve te interesit te zonave te pergjegjesise te filialeve dhe duhet te veprojne si trup vendimarres, eskalues apo marres risku.

- Trupat Menaxhues

    - Drejtoria eshte pergjegjese per mbikqyrjen, zbatueshmerine dhe mirembajtjen e struktures se konflikteve te interesit te RBAL/filialeve te saj dhe ka autoritetin te aprovoje politikat dhe instruksionet perkatese per punonjesit, si edhe te veproje si autoriteti I fundit eskalues i konflikteve te interesit te punonjesve

    - Keshilli Drejtues eshte pergjegjes per mbikqyrjen e struktures se konflikteve te interesit te RBAL/filialeve te saj dhe ka autoritetin te aprovoje politikat dhe instruksionet per anetaret e Trupit Menaxhues, si dhe te veproje si autoriteti I fundit eskaIues I konflikteve te interesit te anetareve te Drejtorise.

Pamundesia per te qene ne perputhje me sa me lart dhe detyrimet raportuese te specifikuara ne kete politike, konsiderohen shkelje te brendshme (ju lutem referojuni Rregullores se Brendshme te Menaxhimit te Shkeljeve te Brendshme).

Zyra e Perputhshmerise

Zyra e Perputhshmerise, rast pas rasti keshillon vendimmarresit ne vleresimin e risqeve te konfliktit te interesit dhe rekomandon masa te duhura mitiguese. Gjithashtu, siguron implementimin dhe pajtueshmerine me strukturen e konfliktit te interesit dhe nxit zhvillimin e standarteve dhe kontrolleve perkatese brenda bankes dhe filialeve te saj. Pergjegjesite kryesore jane si vijon:

- Mirembajtja dhe zhvillimi I struktures dhe standarteve lokale te konfliktit te interesit
- Perkrahje/keshillim operacional I konfliktit te interesit (monitorim, vleresimi dhe identifikim I masave mitiguese) ne RBAL dhe filialet e saj
- Analize e shkakut te konfliktit te interesit dhe modeleve te tij si edhe identifikimi I zonave te permiresuara
- Mirembajtje e kanaleve dhe sistemeve raportues te brendshem te konfliktit te interesit

Pale te tjera Kyce

Pervec Zyres se Perputhshmerise dhe funksionit menaxhues, fuksione te tjera specifike luajne nje rol te rendesishem ne ruajtjen e struktures dhe standarteve te konfliktit te interesit. Funksionet/zonat organizative ne vijim luajne nje rol ten je rendesie te vecante dhe kontibojne me ekspertizen e tyre.

Ligjori: siguron opinion eksperti mbi interpretueshmerine ligjore te ligjeve the rregullave perkatese dhe duhet te veproje sebashku me Zyren e Perputhshmerise si nje qender competence per ngritjen e strukturave institucionale ne parandalimin e konfliktit te interesit.

Komiteti I Pershtatmerise "Fit & Proper Committee": kordinon emerimin e anetareve te rinj te Trupit Menaxhues dhe te Mbajtesve te Fuksioneve Kyce si dhe miremban Listen e Entiteteve te Lidhura Ligjerisht (LoRLE).

Burimet Njerezore: veprojne si perkrahes dhe njesi kontrolluese per linje e pare (FLoD) dhe ka ne zoterim proceset e shperblimit dhe masave disiplinore.

Njesia Pergjegjese per Sekretariatin Ekzekutiv dhe Menaxhimin e Filialeve: kontibon ne identifikimin, vleresimin dhe dokumentimin e situatave te konfliktit te interesit per anetaret e Trupit Menaxhues.

Kontrolli I Brendshem: si linje e trete e mbrojtjes, Kontrolli I Brendshem, mundet te perfshihet ne raste te vecanta ne menaxhimin e konflikteve te interesit, ne rast se keto lidhen me Zyren e Perputhshmerise.

1.4 Procesi I Menaxhimit te Konfliktit te Interesit

Ne pergjithesi, procesi I menaxhimit te konfliktit te interesit duhet te ndjeke 3 hapa:

1. Identifikimi,
2. Raportimi I Brendshem/Venia ne dijeni,
3. Vleresimi dhe mitigimi



Identifikimi

Te qenit ne gjendje te identifikohen konfliktet e interesit eshte me nje rendesi te vecante dhe kusht per nje proces funksional. Ne kete kuptim punonjesit dhe anetaret e Trupit Menaxhues jane vazhdimisht te trajnuar rreth risqeve potenciale dhe detyrat raportuese perkatese.

Raportimi/Berja me dije I brendshem

Me tu identifikuar, konfliktet e interesit duhet te raportohen nepermjet raporteve raportuese ne vend (shih Detyrat raportuese te punonjesve dhe Detyrat raportuese te anetareve te Trupit Menaxhues).

Vleresimi dhe Mitigimi

Zyra e Perputhshmerise (me ndihmen e Linjes se Pare te Mbrojtjes dhe paleve te tjera kyce) eshte pergjegjese per vleresimin e konflikteve te interesit dhe te propozoje -nese nevojitet- masat e duhura per te mitiguar ne menyre te mjaftueshme ndonje risk. Keto vleresimi duhet gjithnje te behen duke u bazuar ne principet ne vijim.

- Principet e Vleresimit

1. Drejtesia – nuk ka trajtime te vecanta ose perjashtime. Duhet te sigurohet qe rrethana te njejta trajtohen njesoj dhe rrethanat jo te njejta nuk trajtohen njesoj.
2. Konfidencialiteti – I gjithe informacioni I marre dhe I raportuar nga punonjesit apo anetaret e Trupit Menaxhues, trajtohet si informacion me konfidencialitet te larte dhe eshte I aksesueshem vetem nga nje rreth I parapercaktuar punonjesish mbi bazen e nevojes per te ditur (psh punonjesit e Zyres se Perputhshmerise, funksione menaxhuese/trupat ku eskalohet rasti.



3. Proporcionalitet dhe mjaftueshmeri e masave – Masat e propozuara duhet te percaktohen ne nje menyre qe te jene te targetuara, proporcionale dhe te mjaftueshme ne varesi te rrethanave dhe te ndryshojne midis konflikteve te interesit te vazhdueshme dhe atyre qe ndodhin per shkak ten je eventi te vecante. Masat e tepruara duhet te menjanohen.

- Masat Mitiguese



Informimi I Brendshem dhe Dokumentimi:

Per situate te parendesishme dhe/ose te perkohshme konflikti interesi, informimi dhe dokumentimi (perfshire pershkrimin) mund te jete I mjaftueshem. Ne disa raste, konfliktet e interesit mund te mitigohen nga Zyra e Perputhshmerise duke patur parasysh detyrimet e konfidencialitetit (sidomos per anetaret e Trupit Menaxhues).



Pranimi/aprovimi I Riskut nga Menaxhimi:

Ne raste kritike dhe sensitive mund te jete I nevojshem nje eskalim ne Funsionet Menaxhuese ose ne Trupat Menaxhues. Funsionet Menaxhuese ose Trupi

Menaxhues merr pjese ne vleresimin e konfliktit te interesit dhe vepron si nje

Classification: GENERAL

autoritet I fundit aprovues, duke vendosur deri ne cfare mase do te pranohen risqet e konfliktit te interesit. Ne raste transaksinesh, kontratash, funksionesh, aktivitetesh biznesi ose raste te tjera me konflikt interesi te parashikuara lokalisht apo nga grupi, duhet te kete nje aprovim te qarte nga Keshilli Drejtues (mund te vendosen masa te tjera kufizuese te fuqise prezantuese te Drejtorise ne lidhje me transaksionet dhe kontratat midis RBAL/filialeve te saj dhe nje anetari te Drejtorise (psh mund te kerkohet ligjerisht qe ne raste te tilla Keshilli Drejtues te perfaqesoje kompanine dhe te nenshkruaje kontraten)).

Periudha "ftohese":

Per raste te vecanta mund te aplikohen periudha "ftohese' perpara se individet e prekur te ekzekutojne funksione te caktuara apo te marrin pjese ne procese te caktuara per te mitiguar "vetekontrollin ose kontrollin" e vendimeve apo aktiviteteve te meparshme (shih Informacioni Konkliktesh te tjera Interesi te raportohen gjate procesit te Fit & Proper (pyetesoret)).

Delegimi dhe abstenimi nga votimi:

Ne shume raste, nje situate konflikti interesi mund te zgjidhet nese veprimtari ose vendime te caktuara ju besohen vendimmarresve te ndryshem duke perfshire komitete te ndryshme (psh ne rast konflikt interesi per nje anetar te Keshillit Drejtues tek nje Komitet Keshilli Drejtues te vecante, etj). Gjithashtu, mospjesemarrja ne takime te caktuara apo abstenimi nga vota mund te jete nje opsion.

Perfundimi I aktiviteteve dhe funksioneve konfliktuale:

Ne rastin e nje konflikt interesi material, ose te vazhdueshem ose te pazgjidhshem, veprimtarive apo pozicioneve konfliktuale mund tu jepet fund (brenda ose jasthe RBAL dhe filialeve te saj). Kjo mund te thothe qe punonjesit apo anetaret e Trupit Menaxhues terhiqen ose ju hiqen mandate apo funksione te caktuara. Per konflikte interesi ekonomike apo profesionale, mund te kete psh shitje te aksioneve te kompanise apo dhenie fund funksionesh specifike.

Raportimi I jashtem:

Nje raportim I jashtem ndaj paleve (psh ndaj klienteve) mund te parandaloje paraqitjen ne nje klime te pakendshme te situatave sensitive. Raportimi I konflikteve te interesit ndaj paleve bashkepunuese duhet te jete nje mase e fundit qe mund te perdoret vetem kur masat e tjera nuk jane te mjaftueshme (kur jepet informacion paleve te jashtme duhet te sigurohet qe kjo lejohet nga ligji I brendshem ose nese ky raportim kerkohet nga ana ligjore).

Strategji te tjera:

Meqenese vleresimi I konflikteve te interesit behet rast pas rasti, mund te kemi nje varietet masash mitiguese te aplikueshme. Tipe te tjera masash mitiguese jane psh kontrollet specifice/veprimtari te kontrolit per te siguruar aplikimin e principit "drejt dhe brenda mundesive".

- Dokumentimi

Vleresimi I konfliktit te interesit duhet te dokumentohet ne systemin COCKPIT (ne disa raste vleresimi mund te dokumentohet diku tjeter (psh minutat te komitetit, protokolle, etj)), duke theksuar vecanerisht se deri ne cfare mase jane mitiguar apo pranuar konfliktet e interesit dhe risqet e lidhura. Ne rast vendimesh apo eventesh specifike si psh aprovimi I transaksioneve apo zgjedhja e nje ofruesi sherbimesh, vleresimi mund te mbahet gjithashtu ne dokumentat respective te ketyre proceseve perkatese (psh ne sistemet perkatese si edhe ne minutat e takimeve (komitetesh), etj).

1.5 Rregullime te vecanta Organizative per te mitiguar Risqe Potenciale Konflikti Interesi ne nivel Institucional

Struktura Organizative e RBAL, filialeve te saj

Ne pergjithesi, duhet te jene te ndertuara baza qe sigurojne nje ndarje detyrash te duhura midis linjes qe ka lidhje direkt me klientin dhe linjes ne mbeshtjetje, midis marresve te riskut dhe atyre qe e kontrollojne, ose funksioneve te tjera me konflikt midis tyre dhe duhet te kete – kur duhet- barriera kalim informacioni (muret kineze) midis linjave te prekura. Per kete ceshtje me teper informacion gjendet ne rregulloren e Grupit mbi Principet Organizative.

Disenjimi dhe ngritja e skemave te shperblimit

Ne pergjithesi, kur pregatiten politikat apo praktikat e shperblimit, banka/filialet e saj duhet te siguroje qe format e shperblimit monetary dhe/ose jo monetary nuk kane incentiva qe demtojne klientet ose banken/filialet e saj. Per kete ceshjte, me teper informacion gjendet ne rregulloren e Grupit mbi Menaxhimin Total te Shperblimeve.

Marredhenie Personale te Punonjesve brenda Bankes, filialeve te saj

Nje marredhenie personale mund te ndikoje vendimet dhe veprimet individuale te nje personi dhe si rrjedhim mund te identifikohet si nje burim konflikt interesi ose risqesh te pergjithshme te perputhshmerise. Ne kete aspekt, marredheniet personale te vecanta midis punonjesve sic jane anetaret e ngushte familjare, marredheniet familjare dhe marredheniet e tjera te ngushta duhet te merren ne vemendje dhe vleresohen nen nje kujdes te vecante.

Dhuratat dhe Ftesat

Dhuratat, ftesat dhe perfitime te tjera materiale dhe jo material jane problematike ne jeten e perditshme pasi ato (sidomos kur lidhen me nje marreveshje konkrete biznesi) mund te influencojne ne nje vendimmarrje objktive dhe te pacenuar, ose ne performancen e detyrave profesionale brenda grupit. Nen rredhana te vecanta Dhurata, ftesa dhe benefite te tjera te tilla jane edhe mund te ndaluahen. Ne lidhje me detyrat raportuese per dhuratat dhe ftesat ju lutem referojuni rregullores lokale mbi Luften kunder Korrupsionit, Mitmarries/Mitdhenies dhe procedures operacionale mbi Menaxhimin e Konflikteve te Interesit.

Principe te pergjithshme:

Ne princip banka lejon marrjen dhe dhenien e dhuratave/shpenzimeve te arsyeshme, te mjaftueshme dhe te limituara, me perjashtim kur kompania marrese ka njoftuar banken qe ndalon pranimin e dhuratave, shpenzimeve te tilla.

Dhurata duhet te jene nje shenje vleresimi, brenda konteksit, zakoneve lokale dhe praktikes se biznesit. Ne asnje menyre ato nuk mund te jene te tilla qe lene vend per interpretim per mitmarrie/mitdhenie apo forma te tjera kompensimi, pagese.

Vleresimi I konfliktit te interesit duhet te dokumentohet ne systemin COCKPIT (ne disa raste vleresimi mund te dokumentohet diku tjeter (psh minutat te komitetit, protokolle, etj)), duke theksuar vecanerisht se deri ne cfare mase jane mitiguar apo pranuar konfliktet e interesit dhe risqet e lidhura. Ne rast vendimesh apo eventesh specifike si psh aprovimi I transaksioneve apo zgjedhja e nje ofruesi sherbimesh, vleresimi mund te mbahet gjithashtu ne dokumentat respective te ketyre proceseve perkatese (psh ne sistemet perkatese si edhe ne minutat e takimeve (komitetesh), etj).

